

Se souvenir de la brebis

Par William K. Jackson
des soixante-dix

T'i Kujtojmë Delet

Nga Plaku Uilliam K. Xhekson,
i Të Shtatëdhjetëve

Conférence générale d'octobre 2025

Le principe de dénombrer et de rendre compte fonctionne. C'est la manière du Seigneur.

Le Christ est le Bon Berger. Chacun des membres du troupeau est précieux à ses yeux. Il a montré comment prendre soin du troupeau et nous a enseigné par ses paroles et ses actes les qualités d'un bon berger : connaître ses brebis par leur nom, les aimer, retrouver celles qui sont perdues, les nourrir et, finalement, les ramener de nouveau au foyer. Il attend de nous que nous agissions de la même manière en tant que bergers adjoints.

L'exemple de Moroni, ancien prophète et berger exceptionnel, nous en apprend beaucoup sur ce que l'on peut faire pour servir à la manière du Seigneur. Il a vécu à une époque très difficile. Il ne bénéficiait pas de téléphone portable, d'ordinateurs ou d'Internet. Mais il a réussi à suivre attentivement les brebis. Comment y est-il parvenu ? Nous avons un aperçu de sa méthodologie dans Moroni 6. Nous y lisons que les membres « étaient comptés parmi le peuple de l'Église du Christ ; et leur nom était pris, pour qu'on se souvînt d'eux et qu'on les nourrit de la bonne parole de Dieu, pour les garder dans la voie droite. [...] Les membres de l'Église se réunissaient souvent pour jeûner et pour prier, et pour se parler l'un à l'autre du bien-être de leur âme » (Moroni 6:4-5).

Pour Moroni, tout était une question de personnes, de noms ! Il savait dénombrer et rendre compte afin qu'on se souvienne de tous. Il remarquait ceux qui étaient en difficulté ou qui erraient, permettant ainsi aux saints de discuter de leur bien-être en conseil. Comme le berger qui a laissé les quatre-vingt-dix-neuf autres brebis, en

Parimi i numërimit dhe përkujdesjes funksionon. Ajo është mënyra e Zotit.

Krishti është Bariu i Mirë. Secili në tufë është i çmuar për Të. Ai dha modelin e të qenit bari dhe na mësoi me anë të fjalës dhe veprës cilësitë e një bariu të mirë, përfshirë njohjen e deleve të tij me emër, dashurinë për to, gjetjen e atyre që kanë humbur, të ushqyerit dhe, në fund, çuarjen e tyre sërish në shtëpi. Ai pret që ne të bëjmë të njëjtën gjë si ndihmësbarinj të Tij.

Ne mund të mësojmë shumë rreth dhënies së shërbesës sipas mënyrës së Zotit nga profeti i lashtë dhe bariu i jashtëzakonshëm, Moroni. Ai jetoi gjatë kohëve shumë të vështira, pa pasur përfitimet e telefonave celularë, kompjuterëve dhe internetit. Por ai ia doli mbanë që të ndiqte gjendjen e deleve të tij. Si u bë kjo gjë ? Ne marrim një këndvështrim sado të vogël të metodologjisë së tij të Moroni 6. Atje lexojmë se anëtarët “u numëruan mes njerëzve të kishës së Krishtit; dhe emrat e tyre u morën kështu që ata të mund të kujtoheshin dhe të ushqeheshin nga fjala e mirë e Perëndisë, për t'i mbajtur në udhën e drejtë.... Kisha mbledhej së bashku shpesh për të agjëruar, për t'u lutur dhe për të folur me njëri-tjetrin, në lidhje me mirëqenien e shpirtit të tyre” (Moroni 6:4-5; theksimi i shtuar).

Për Moronin e tëra ishte rreth njerëzve – emrave ! Ai praktikoi parimin e numërimit dhe përkujdesjes me qëllim që të gjithët i kujtonin ata. Kushdo që po haste vështirësi ose po endej u vu re, duke i lejuar shenjtorët që të diskutonin në këshilla për mirëqenien e tyre. Sikurse bariu që i la të nëntëdhjetë e nëntat (të sigurta e pa rrezik,

sécurité, j'en suis certain, pour aller à la recherche de celle qui était perdue (voir Luc 15:4-7), il nous est demandé d'être tout aussi attentifs à nos troupeaux, de les compter, de nous souvenir d'eux, et d'aller et de faire de même.

Quand j'étais dirigeant de mission en Inde, je me souviens avoir demandé à un jeune président de branche quels étaient ses objectifs pour l'année à venir, notamment : « Combien d'hommes allez-vous préparer à recevoir la Prêtrise de Melchisédek ? » Il a répondu immédiatement : « Sept ! »

Je me demandais d'où il avait bien pu tirer, comme par magie, ce chiffre très précis ! Avant que je puisse répondre, il a sorti une feuille de papier sur laquelle étaient écrits sur le côté les chiffres d'un à sept. Sur les cinq premières lignes, on lisait les noms de personnes déjà identifiées, que son collègue d'anciens et lui allaient inviter et encourager à recevoir la bénédiction de la prêtrise. Bien sûr, j'ai voulu en savoir plus sur les lignes six et sept restées vides. Secouant la tête avec sympathie, il m'a dit : « Oh, frère, nous allons certainement baptiser au moins deux hommes au début de l'année qui pourraient avoir la prêtrise d'ici la fin de l'année. » Ce dirigeant remarquable comprenait l'importance de dénombrer et rendre compte.

Le Christ a organisé son Église de manière à ce qu'aucune âme ne soit oubliée, car chacune lui est chère. Dans une paroisse, chaque membre, quel que soit son âge ou son genre, est entouré de nombreux intendants, des bergers, qui ont la tâche de veiller sur lui et de se souvenir de lui. Un jeune homme, par exemple, bénéficie du soutien de nombreuses personnes désignées pour veiller à son bien-être : un évêque, des frères de service pastoral, des consultants adultes pour les jeunes, des instructeurs du séminaire, des présidences de collège et d'autres encore, qui servent tous de filets de sécurité, solidement accrochés sous ce jeune pour le rattraper s'il tombe. Même si un seul filet est correctement positionné, ce jeune homme sera en sécurité, on fera attention à lui et on se souviendra de lui. Pourtant, souvent, il n'y a pas le moindre filet en place. Les gens s'égarent régulièrement dans le brouillard de ténèbres et personne ne s'en aperçoit. Comment pouvons-nous devenir de meilleurs bergers ? Nous pouvons apprendre à dénombrer et à rendre compte.

L'Église nous fournit des rapports et des out-

jam i sigurt) dhe shkoi pas një deleje që kishte humbur (shihni te Llukë 15:4-7), neve na është kërkuar që të jemi po aq të vetëdijshëm për tufat tona, që të vëmë re e të kujtojmë dhe të shkojmë e të bëjmë po ashtu.

Si udhëheqës misioni në Indi më kujtohet që i kërkoja një presidenti dege, i ri në moshë, rreth disa prej synimeve të tij për vitin e ardhshëm: “Sa meshkuj do të përgatitësh për të marrë Priftërinë Melkizedeke?” Përgjigjja e tij e menjëhershme qe: “Shtatë!”

Pyesja veten se nga e kishte nxjerrë atë numër aq specifik! Përpara se të mund të përgjigjesha, ai nxori një fletë letre me numrat një deri në shtatë të shkruar në anën e saj. Pesë rreshtat e parë kishin emra në to – njerëz të vërtetë që ai dhe kuorumi i tij i pleqve do t'i ftonin dhe nxitnin që të kishin bekimin e priftërisë në jetën e tyre. Sigurisht, m'u desh të pyesja për rreshtat gjashtë dhe shtatë që ishin bosh. “O, President”, – tha ai, duke tundur kokën me mirëkuptim, – “sigurisht që do të pagëzojmë të paktën dy burra në fillim të vitit të cilët mund të kenë priftërinë në fund të vitit”. Ky udhëheqës i shkëlqyer e kuptonte parimin e numërimit dhe përkujdesjes.

Krishti e ka organizuar Kishën e Tij në një mënyrë të tillë që duhet të jetë e vështirë që të harrohet qoftë edhe një shpirt, sepse secili është i dashur për Të. Çdo individ në lagje, pavarësisht nga moshë ose gjinia, ka një mori kujdestarësh – barinjsh – të cilëve u është dhënë detyra që të kujdesen për ta, duke i kujtuar. Një të riu, për shembull, i është caktuar për mirëqenien e tij një peshkopatë, vëllezër shërbetarë, këshilltarë në moshë madhore për të rinjtë, mësues të seminarit, presidenca të kuorumeve dhe pastaj të tjerë, të gjithë duke shërbyer si rrjeta mbrojtëse, të lidhura fort nën atë të ri, që ta kapin nëse bie. Edhe nëse vetëm një rrjetë është e vendosur siç duhet, ai i ri do të jetë i sigurt, i vënë re dhe i kujtuar. Dhe përsëri, shpesh zbulojmë se nuk ka një rrjetë në vendin e duhur. Njerëzit enden rastësisht nëpër mjegullat – dhe askush nuk i vë re. Si mund të jemi barinj më të mirë? Ne mund të mësojmë që t'i numërojmë të tjerët dhe të përkujdesemi për ta.

Kisha na siguron raporte dhe mjete për

ils pour faire exactement cela : nous souvenir. Le rapport trimestriel en est un excellent exemple. Il nous permet de dénombrer chaque membre, de rendre compte de sa situation à plusieurs reprises et de remarquer ceux qui sont absents ou qui ont besoin de notre aide et de notre amour. La liste d'actions et d'entretiens à mener identifie les personnes qui ont actuellement besoin de notre attention, de même que le rapport sur le statut des recommandations pour le temple et d'autres rapports. Ces outils de dénombrement et de compte-rendu nous permettent de nous focaliser sur les personnes. Qui a besoin d'un appel, d'un avancement dans la prêtrise ou d'aide pour apporter le nom d'un ancêtre au temple ? Qui pourrions-nous aider à se préparer à une mission à plein temps ? Qui n'a-t-on pas vu ce mois-ci ? Ces outils nous permettent de nous souvenir des personnes.

Je connais une famille aux États-Unis qui a accepté une affectation en Afrique. Le tout premier dimanche, ils sont entrés dans la seule unité de l'Église du pays, où ils ont été accueillis avec enthousiasme. À la fin de la matinée, l'épouse a été appelée présidente de la Société de Secours et lui dirigeant des Jeunes Gens ! Il a demandé au président de branche qui avait l'air épuisé combien il y avait de jeunes gens. Ce dirigeant fidèle, membre de première génération, a montré du doigt le fond de la salle de Sainte-Cène et a dit : « Ces deux-là. » L'homme était sceptique, à juste titre. Il a donc emporté chez lui une liste de membres de la branche et a rapidement remarqué qu'il y avait en fait vingt jeunes gens sur la liste. Il est retourné voir le président de branche et a demandé que deux jeunes adultes dynamiques et bilingues lui servent de conseillers, puis il s'est assis avec eux et les deux garçons pour revoir les noms de la liste.

Ensuite, ces jeunes gens diligents se sont mis au travail. Au cours des mois suivants, ils ont trouvé tous les garçons enregistrés sur la liste. Nom après nom, ces brebis perdues ont été accueillies par leurs camarades, et nourries spirituellement et physiquement ! En l'espace d'un an, chaque dimanche, on observait une moyenne de vingt et un jeunes gens présents aux réunions. Que Dieu soit loué pour ces jeunes gens qui dénombrèrent et rendaient compte.

Un ami cher, alors jeune étudiant de troisième cycle, a déménagé avec sa famille dans une grande ville américaine pour poursuivre ses

të bërë pikërisht këtë – të kujtojmë. Raporti Tremujor është një shembull parësor. Na lejon t'i numërojmë dhe të përkujdesemi për çdo anëtar shumë herë dhe të vëmë re ata që humbasin ose kanë nevojë për ndihmën tonë dhe dashurinë tonë. Lista e Veprimeve dhe Intervistave përcakton ata që kërkojnë vëmendjen tonë pikërisht tani, të njëjtin rol luan edhe raporti i Gjendjes së Rekomandimit të Tempullit e të tjera. Këto mjete të numërimit dhe përkujdesjes na përqendrojnë tek njerëzit. Kush ka nevojë për një thirrje, një hap përpara në priftëri ose ndihmë për ta çuar një emër të familjes në tempull? Kë mund të ndihmojmë që të përgatitet për një mision kohëplotë? Kush mungoi këtë muaj? Këto mjete na ndihmojnë që të kujtojmë njerëzit.

Njihja një familje nga Shtetet e Bashkuara që pranoi një detyrë në Afrikë. Në të dielën e tyre të parë fare, ata u futën në të vetmen njësi të Kishës në atë shtet, ku u përshëndetën plot entuziazëm. Pa kaluar mirë mëngjesi, bashkëshortja e burrit kishte marrë thirrjen si presidente e Shoqatës së Ndihmës dhe ai si udhëheqës i Të Rinjve. Ai e pyeti një president dege, në dukje të lodhur, se sa të rinj kishte atje. Ky udhëheqës besnik, i brezit të parë në Kishë, tregoi me gisht për nga fundi i sallës së sakramentit dhe tha: "Ata të dy atje". Burri ishte vërtet skeptik, prandaj e mori në shtëpi listën e anëtarëve të degës, duke i rënë menjëherë në sy se në fakt kishte 20 të rinj në listë. Ai u kthye te presidenti i degës dhe kërkoi që dy të rinj në moshë madhore, energjikë dhe që i flisnin të dyja gjuhët, të shërbenin si këshilltarët e tij dhe më pas u ul me ta dhe dy djemtë që të rishikonin emrat.

Më pas këta të rinj të zellshëm iu futën punës. Gjatë pak muajve që pasuan, ata e gjetën çdo djalë në listë. Emër për emër, ato dele të humbura u mirëpritën përsëri nga bashkëmoshatarët e tyre dhe u ushqyen shpirtërisht e fizikisht. Brenda një viti, në çdo të diel më pas, pati një mesatare prej 21 të rinjsh të pranishëm. U qofshim falë të rinjve që numëruan dhe dhanë përkujdesje!

Një miku im i dashur, kur ishte një student i sapodiplomuar, u shpërngul me familjen e vet në një qytet të madh amerikan për të vazhduar

études. Il a immédiatement été appelé à présider le collège des anciens. Un peu inquiet à l'idée de son premier entretien avec le président de pieu, il avait décidé d'arriver préparé. Il a dit au président de pieu qu'il avait trois objectifs pour l'année à venir : (1) 90 % de service pastoral (2) un enseignement approfondi de l'Évangile chaque semaine et (3) une activité de collège bien planifiée chaque mois.

Ce président de pieu avisé a demandé à mon ami en souriant : « Pourriez-vous me donner le nom d'un membre du collège qui est non-pratiquant et que vous pourriez accompagner avec sa famille au temple cette année ? » Cette question a pris mon ami par surprise. Il a réfléchi attentivement et a trouvé un nom. « Écrivez-le », lui a recommandé le président de pieu. Puis ce dirigeant expérimenté a posé la même question à trois reprises et l'entretien s'est terminé. Ce jeune homme est sorti de cet entretien en ayant appris l'une des plus grandes leçons sur l'art de diriger et de servir. Il était venu à l'entretien avec des programmes, des leçons et des activités. Il est reparti avec des noms ! Mon ami et son collègue ont par la suite fait de ces quatre noms leur priorité.

En tant que dirigeant de mission, j'ai rendu visite à l'une de mes branches un dimanche matin. J'ai remarqué que le président de branche ne cessait de sortir une fiche de sa poche pour écrire dessus. Après la prière de clôture, j'ai décidé de lui demander de quoi il s'agissait. Une fois la réunion terminée et avant que j'aie pu le questionner sur la fiche, le dirigeant de mission de branche s'est précipité sur l'estrade et le président lui a remis la fiche. Rapidement, j'ai suivi ce dirigeant enthousiaste à sa réunion hebdomadaire de coordination missionnaire de branche. Avant que la réunion commence, il a sorti le papier de sa poche. Il était rempli des noms des membres absents à la réunion de Sainte-Cène. En quelques minutes, chaque membre du conseil avait choisi un nom ou deux, s'engageant à rendre visite aux personnes le jour même pour s'assurer qu'elles allaient bien et pour leur faire savoir qu'on avait regretté leur absence. Voilà ce qu'on appelle dénombrer et rendre compte.

Je me souviens d'un district, à plusieurs heures d'avion du temple le plus proche, qui avait comme priorité absolue de s'assurer que chaque membre ait une recommandation pour le temple valide, en dépit du fait qu'elle ne serait probablement jamais utilisée. Le premier dimanche de

arsimimin. Menjëherë u thirr që të kryesonte mbi kuorumin e pleqve. Disi në ankth për intervistën e tij të parë me presidentin e kunjit, ai ishte i vendosur për të shkuar i përgatitur. I tha presidentit të kunjit se ai kishte tre qëllime për vitin e ardhshëm: 1) 90 përqind në dhënien e shërbesës, 2) një mësim thelbësor për ungjillin çdo javë dhe 3) një aktivitet të planifikuar mirë për kuorumin çdo muaj.

Duke i buzëqeshur mikut tim, ky president i mençur kunji e pyeti: "A mund të më thuash emrin e një anëtarit joaktiv të kuorunit që mund ta ndihmosh të shkojë në tempull me familjen e tij këtë vit?" Kjo pyetje e befasoj mikun tim. Mendoj me kujdes dhe e gjeti një emër. "Shkruaje atë emër", – e udhëzoi presidenti i kunjit. Pastaj ky udhëheqës me përvojë e bëri të njëjtën pyetje tri herë të tjera, dhe intervista mbaroi. Ky i ri doli nga ajo intervistë duke marrë njërin nga mësimet e tij më të mëdha për udhëheqjen dhe dhënien e shërbesës. Ai shkoi në intervistë me programe, mësim dhe aktivitete. Ai doli nga dera me emra! Ata katër emra më pas u bënë fokusi i tij kryesor dhe i kuorunit të tij për dhënie shërbese.

Si udhëheqës misioni vizitova njërin nga degët e mia një mëngjes të diele. Vura re se presidenti i degës herë pas here nxirrte një fletë letre nga xhepi dhe shkruante në të. Vendosa ta pyesja për këtë pas lutjes së mbylljes. Kur mbaroi mbledhja dhe përpara se të mund të pyesja për fletën e letrës, udhëheqësi i misionit të degës eci me të shpejtë drejt podiumit, ku atij iu dha fleta. Me shpejtësi e ndoqa këtë udhëheqës entuziast për të mbledhja e tij e përjavshme e bashkërendimit me misionarët e degës. Përpara se të filloin, ai e nxori letrën nga xhepi. Ishte e mbushur me emrat e anëtarëve që kishin munguar në mbledhjen e sakramentit. Brenda pak minutash çdo anëtar i këshillit kishte përzgjedhur një ose dy emra, duke u zotuar që të takojë me ta po atë ditë për t'u siguruar që ishin në rregull dhe për t'u treguar se u ishte ndier mungesa. Tanikështë parimi i numërimit dhe përkujdesjes.

Më kujtohet një distrikt, disa orë me avion nga tempulli më i afërt, ku mbajtja e një rekomandimi aktual ishte një përparësi e madhe, pavarësisht nga fakti që ndoshta nuk do të përdorej kurrë. Të dielën e parë të çdo muaji udhëheqësit i përdornin mjetet e tyre të numërimit për t'u

chaque mois, les dirigeants utilisaient leurs outils de suivi pour recenser leurs membres dotés. S'ils constataient qu'une recommandation arrivait bientôt à expiration, le secrétaire exécutif planifiait un entretien pour son renouvellement. On tenait conseil au sujet des membres dont la recommandation avait expiré, puis on cherchait activement à leur venir en aide pour qu'ils reviennent sur le chemin des alliances. J'ai demandé combien de membres dotés avaient une recommandation valide. La réponse a été un stupéfiant 98,6 %. Lorsque j'ai demandé ce qu'il en était des six personnes dont la recommandation avait expiré, les dirigeants ont pu me donner leur nom et m'ont décrit les efforts déployés pour les ramener !

Il y a quelques années, ma famille et moi sommes retournés vivre aux États-Unis. Nous étions enthousiastes à l'idée d'assister aux réunions de l'Église ici après vingt-six années extraordinaires passées dans des unités plus petites et plus isolées. J'ai été appelé comme missionnaire de paroisse. Nous avions un excellent dirigeant de mission de paroisse et nous faisons des choses enthousiasmantes et instructions des gens merveilleux. J'ai demandé à assister à une réunion du conseil de paroisse pour observer les échanges et obtenir de l'aide pour les amis avec lesquels nous travaillions. À ma surprise, la discussion s'est limitée à une activité de paroisse à venir. Après la réunion, j'ai abordé le dirigeant de mission de paroisse et lui ai fait remarquer qu'il n'avait pas eu l'occasion de faire un rapport au sujet de nos amis. Sa réponse ? « Oh, je n'ai jamais l'occasion de faire un rapport. »

J'ai comparé cela à une réunion du conseil de branche à Lahore, au Pakistan, à laquelle j'avais assisté quelques semaines auparavant. Ce petit groupe de personnes s'était assis ensemble autour d'une petite table pour ne parler que de personnes, de noms. Chaque dirigeant avait fait rapport de son intendance, et des personnes et des familles qui le préoccupaient. Tous avaient eu l'occasion d'exprimer leurs idées sur les meilleures façons de servir les personnes dont il était question. Des plans avaient été élaborés et des tâches données. Quelle merveilleuse leçon de la part de nos frères et sœurs de la première génération sur la manière de dénombrer et de rendre compte nominativement !

Dans l'Église de Jésus-Christ, nous avons reçu, par l'intermédiaire des prophètes passés et

përkujdesur për anëtarët e tyre që e kishin marrë dhurimin. Nëse zbulonin që një rekomandimi do t'i mbaronte vlefshmëria së shpejti, sekretari ekzekutiv do të caktonte një intervistë për ta përtërirë. Njerëzit me rekomandime që u kishte mbaruar vlefshmëria, këshilloheshin për këtë, më pas përpqeshin që t'i ndihmonin për t'u kthyer në shtegun e besëlidhjeve. Pyeta se sa veta prej anëtarëve të tyre që e kishin marrë dhurimin, kishin një rekomandim aktual. Përgjigjja ishte një 98,6 përqindje e mahnitshme. Kur u pyetën për ata gjashtë veta, rekomandimeve të cilëve u kishte mbaruar vlefshmëria, udhëheqësit ishin në gjendje t'i përcaktonin me emër dhe më përshkruan përpjekjet që po bëheshin për t'i kthyer përsëri.

Disa vite më parë familja ime u kthye në Shtetet e Bashkuara. Ishim të emocionuar që të frekuentonim kishën këtu pas 26 vitesh të mrekullueshme në njësi më të vogla, më të izoluara. U thirra si misionar i lagjes. Kishim një udhëheqës të shkëlqyer misioni të lagjes dhe po bënim gjëra emocionuese dhe po u jepnim mësim njerëzve të mrekullueshëm. Kërkova që të frekuentoja një mbledhje të këshillit të lagjes për të vëzhguar dhe marrë ndihmën e tyre për miqtë me të cilët po punonim. U habita kur gjithçka që u diskutua ishte një aktivitet i ardhshëm i lagjes. Iu drejtova udhëheqësit të misionit të lagjes më pas dhe i shpreha mendimin se ai nuk pati mundësinë që të fliste e të raportonte për njerëzit tanë. Përgjigjja e tij? “O, kurrë nuk arrij të raportoj.”

E krahasova atë me një mbledhje të këshillit të degës në Lahorë të Pakistanit, në të cilën kisha marrë pjesë pak javë më parë. Ky grup i vogël u ul së bashku përreth një tavoline të vogël dhe gjithçka për të cilën folën ishin njerëzit. Emrat. Secili udhëheqës raportoi për kujdestarinë e vet dhe individët e familjet për të cilët qenë të shqetësuar. Të gjithë patën mundësinë që të jepnin mendimet e tyre për mënyrat më të mira që mund t'i bekonin ata që po diskutoheshin. U bënë plane dhe u dhanë detyra. Çfarë mësimi i shkëlqyer për numërimin dhe përkujdesjen me emër nga vëllezërit dhe motrat tona të brezit të parë!

Në Kishën e Jezu Krishtit ne jemi udhëzuar nga profetët e së shkuarës dhe profetët e të sot-

actuels, et par le modèle établi par notre Sauveur, des instructions sur la manière de servir. Nous prenons les noms, nous nous souvenons des personnes et nous tenons conseil sur le bien-être des âmes. Les dirigeants qui font cela ne seront jamais à court de points à l'ordre du jour de leurs réunions de conseil ! Le fait de dénombrer et de rendre compte fonctionne bien. C'est la manière de faire du Seigneur. Nous pouvons faire mieux. Pour Dieu, qui a créé l'univers et règne sur tout, cette œuvre, son œuvre et sa gloire, est très personnelle. Et il devrait en être de même pour chacun de nous, en tant qu'instruments entre ses mains dans son œuvre prodigieuse de salut et d'exaltation. Il en résultera des miracles dans la vie de vraies personnes. Au nom de Jésus-Christ. Amen.

mes dhe nga modeli i caktuar prej Shpëtimtarit tonë, se si të japim shërbesë. Marrim emrat, i kujtojmë dhe këshillohemi për mirëqenien e shpirtave. Udhëheqësit që e bëjnë këtë gjë, kurrë nuk ngelen pa pika të rendit të ditës në mbledhjet e këshillit të tyre. Parimi i numërimit dhe përkujdesjes funksionon. Ajo është mënyra e Zotit. Ne mund ta bëjmë më mirë. Për Perëndinë, i cili krijoi gjithësinë dhe sundon mbi gjithçka, kjo veprë – vepra dhe lavdia e Tij – është shumë vetjake. Dhe e tillë duhet të jetë për secilin prej nesh, si mjete në duart e Tij në veprën e Tij mahnitëse të shpëtimit dhe të ekzaltimit. Si rrjedhim, në jetën e njerëzve të vërtetë do të vijë mrekulli. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.